



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 25 Prot

Tiranë, më 25.02.2010

VENDIM Nr. 50, dt. 16.02.2010

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 16.02.2010, mbasi shqyrtoi projektin "Godinë banimi dhe shërbimesh 2-3-6kt +2kt nën tokë" zona "B", Durrës, nga subjekti "SIP" sh.p.k,

VENDOSI:

- I. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik të kryejë sondazhin arkeologjik në sheshin e ndërtimit të subjektit "SIP" sh.p.k, në adresën Lagja 11, Sheshi "Demokracia" Rr. P.Meksi, Durrës.
- II. Subjekti "SIP" sh.p.k, të lidhë kontratën dypalëshe me ASHA-n për kryerjen e sondazhit arkeologjik.
- III. Pas miratimit të raportit të sondazhit arkeologjik nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë do të vendoset lejimi ose jo i punimeve të ndërtimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
FERDINAND XHAFERAJ

SEKRETARI I KKA
ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al